

# DESHTIMI INJE DREDHIE

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-93-32

R 57

**BAJRAM RESULI**

*TREGIME*

814-93-32

R 57.

BIBLIOTEKA E PIONIERIT

BAJRAM RESULI

# DËSHTIMI I NJË DREDHIE

— Tregime —



2168

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KUR DOLA PARTIZAN

Kishim dëgjuar se në mal kishin dalë partizanë. Por, se si qenë ata, nuk e dinim. Ishte fillimi i Luftës Nacional-çlirimtare. Shumë gjëra thuheshin atëherë. Kishte që thoshin se partizanët luftojnë për të mirën e popullit, për të fituar lirinë, por kishte edhe të atillë, që nxirrnin nga goja fjalët më të poshtra, si Sefedin agai, Sulo Sinani dhe kapteri i milicisë, Dule Gjerbësi.

Unë ruaja dhitë atëherë. Isha gati 15 vjeç. Kisha një fyell dhe po i bija si zakonisht. Dhitë po kullosnin në një pllajë. Kur pashë se drejt meje po vinin disa njerëz, e hoqa fyellin nga buzët dhe i vështrova. Në fillim u tremba, se mos ishin hajdutë.

— E, o çoban i vogël, si je? — më tha njëri prej tyre. Unë u çudita. Deri atëherë s'kisha parë njerëz të atillë. Ishin të armatosur, me gjerdanë fishekësh në brez dhe me yje të kuq në kapele. Po, mbi të gjitha, u çudita, kur vëreja se në mes tyre kishte edhe vajza dhe disa djem, moshatarë me mua. Edhe ata mbanin dyfek në sup dhe gjerdanë me fishekë në brez. Unë s'kisha parë kurrë vajza me pantallona dhe me kapele, prandaj u çudita shumë. S'dija ç'të thosha.

— Mos ki frikë, more djalë, se ne jemi vëllezërit e tu! — foli ai që më kishte pyetur. Rreth meje u mblodhën dhe të tjerë.

— Jo, — iu përgjigja. — Nuk kam frikë. Fillova t'i vështroja me radhë.

— Jemi partizanë, — tha njëri. — Ke dëgjuar për partizanët?

— Po, — i thashë. — Kam dëgjuar!

Pastaj ata më pyetën se ç'flitej në fshat për ta. Unë u tregova gjithçka. Ata ndenjën më shumë se një orë pranë meje, më thanë përse luftonin dhe se gjithkush ishte mirë të merrte pjesë në luftë kundër armikut. Partizanët bisedonin me mua sikur të isha shoku i tyre, sikur të më kishin njohur shumë kohë më parë. Kur ikën, më përqaftuan të gjithë me radhë. Unë i ndoqa me sy derisa kaluan malin.

«Çudi, sa të mirë qenkan! — thashë me vete. Që prej asaj dite fillova ta urreja keq Sefedin aganë dhe shokët e tij.

Një natë, kur u ktheva me dhitë, gjeta në shtëpi pesë partizanë. Dy nga ata, qenë prej atyre që pata takuar. Sa u gëzova kur i pashë! I përqaftova i gëzuar.

U ula pranë partizanëve. Midis tyre ishte edhe një djalë sa unë dhe një vajzë po aq e vogël. Të gjithë kishin në kapele yll të qindisur, rreth qafës u dukej shamia e kuqe. Ju afrova edhe më pranë moshatarit tim. E shikoja me zili. Në brez kishte një revolver, kurse krahqafë mbante një gjerdan me fishekë. I armatosur, më dukej si ndonjë burrë i madh. Vetiu nisa të druhesha prej tij. Kur s'merrja vesh ç'më pyeste, i thosha «urdhëro?» e i përgjigjesha «si urdhëron!» Pranë ne të dyve u afrua pas pak vajza partizane. Më shikoi me vërejtje dhe pastaj më tha:

— Po ti, pse nuk del partizan?

Heshta. Më vinte zor t'i tregoja se nuk më linte babai. Atë çast im atë hodhi sytë nga unë. Duket i bëra përshtypje ashtu kokëvarur.

— E, — më tha, — sa ti janë!

— Po, — ia ktheva, mora zemër dhe i thashë: — Edhe unë do të dal si këta partizan.

Babai s'foli, vetëm buzëqeshi.

— Djali ka qejf të vijë me ne, — tha partizania. Babai përsëri buzëqeshi pa folur.

— Ja, ne, ç'jemi që kemi lënë nënat, baballarët, motrat e vëllezërit? — u dëgjua prapë zëri i partizanes.

— Më duket i vogël akoma, moj bijë, — iu përgjigj ai më në fund si me drojtje. Pastaj m'u drejtua mua:

— Si thua ti, Beso?

— Të shkoj! — ia prita i vendosur.

— Po fundi, mirë do të bësh, — tha babai. — Me shokë do të jesh e jo vetëm.

Unë, nga gëzimi, iu hodha babait dhe e putha, pastaj u përqafova me partizanët.

— Na u shtua edhe një shok! — thirrën ata tërë gëzim.

— Tani shko në plevicë dhe merr një plaçkë atje në fund, mbuluar me kashtë! — tha babai.

Të them të drejtën, unë nuk dija se për çfarë plaçke e kishte fjalën im atë. Shkova atje, hapa kashtën, kur ç'të shikoja! Ishte një pushkë e shkurtër dhe një gjerdan me fishekë. Sytë më ndritën. Hodha gjerdanin krahpafë, siç kishte bërë ai partizani i vogël, pushkën mbi sup dhe u ktheva me vrap. Sa u gëzuan partizanët, kur më panë me pushkë në krah! Gati deri në mes të natës partizania dhe partizani i vogël më treguan se si qëlloj. Pastaj babai më porositi:

— Bir, ti po shkon partizan. Të qoftë udha e mbarë! Pushka top t'u bëftë! Edhe unë, po të mos isha i sëmurë, do të dilja, por ç't'i bëj gjurit!

Të nesërmen u ngritëm heret. Edhe nga shtëpitë e fshatarëve të tjerë dilnin partizanë dhe partizane. Shkuam të parët te sheshi i fshatit. Atje po mblidhej e gjithë çeta. Këndonin, kërcenin. Bashkë me partizanët, te sheshi u mblodhën edhe fshatarë dhe fshatare. Edhe ata u përzien

në këngë e valle. Pastaj u dha urdhri që të rreshtoheshim dhe të niseshim për udhëtim. Nisëm të ecnim, duke kënduar këngën «Bashkohuni, o shokë, me ne në çetë!» Populli na përshëndeste me dorë, disa vajza pak më larg turmës na tundnin shamitë që mbanin nëpër duar. Ne lëvizim prapa shtëpitë, kopshtet e bukura, livadhet dhe erën e këndshme të pemëve të pjekura.

Ishte vjeshtë e vitit 1943, dita ime e parë e jetës partizane.

## DËSHTIMI I NJË DREDHIE

Më kujtohet si tani. Atëherë sapo i kisha mbushur të pesëmbëdhjetë vjetët. Ishte një pasdite e nxehtë e qershorit 1943. Në shtëpinë tonë befas hynë tre milicë, me krycplakun e fshatit përpara. Ata mbanin nëpër duar pushkë të gjata italiane, që i drejtuan nga ne, dhe bërtitën si të tërbuar:

— Selami, ku është Selami! Asnjë të mos luajë nga vendi!

Pra, kërkonin tim atë. Dhe e gjetën shpejt. Ai po flinte. Porsa ishte kthyer nga një udhëtim i largët, që kishte zgjatur më shumë se tri ditë. Babai largohej shpesh nga shtëpia dhe ne as që e dinim se ku vinte. Atë ditë ai kish-te ardhur tepër i lodhur. As bukë nuk hëngri, bile as u zhvesh, por ra menjëherë në gjumë. Milicët e zgjuan duke e qëlluar me qytat e pushkëve. Pastaj ia lidhën duart me hekura. Unë u turra mbi babanë që ta shpëtoja prej milicëve, por njëri prej tyre më qëllloi aq fort në kokë me kondak, sa që rashë përdhe pa ndjenja. Kur erdha në vete, nuk e pashë më tim atë. Pranë meje ndodhej nëna, e cila më thoshte duke fshirë lotët dhe duke më lëmuar nga flokët:

— Bir i nënës! Si ndihesh tani? Fol, të keqen!

Nuk flisja dot, vetëm e shikoja në sy.

— O, kriminelë, o kriminelë, që nuk ju vjen keq as për fëmijët! — vazhdonte nëna. — Ngordhshi si qentë

në ndonjë përrua! U shoftë emri juaj e mos u kthefshi të gjallë nëpër shtëpira!

— Babai, ku është babai? — shqiptova ngadalë.

— E morën kriminelët, bir.

U ngrita me mundim. Ndieja dhembje të madhe në kokë. Nëna ma lidhi shpejt vendin e qëlluar. Plaga m'u mbyll pas një muaji. Vetëm flokë në atë vend nuk më kanë dalë as sot e kësaj dite.

Tim atë e kishin çuar në burgun e qytetit, që ndodhej nja dy orë larg fshatit tonë. Unë me nënën shkqonim gati për çdo javë në burg, po babanë nuk e takonim dot, bile as e shikonim qoftë edhe përmes hekurave, sepse nuk na linin policët. I çonim vetëm ndonjë gjë për të ngrënë dhe na dukej sikur na hiqej pak ai mall i madh që kishim për të. Polici që na merrte shportën me ushqime, na e kthen-te atë bosh pas dhjetë minutave.

— Ia dhamë, dreqit të mallëkuar, — na thoshte. —  
— Shporruni tani.

Kur e pyesnim për shëndetin e babait, ai na përgjigjej tërë inat:

— Euaaa! Akoma s'ia kanë dhënë gjysmën e lekut!  
Bëhem merak fort unë. Lipsuni këtej, atë bëni!

Një ditë shkova në burg vetëm, se nëna ishte e sëmurë. Mbusha një shportë me fiq të zes dhe u nisa herët në mëngjes. Arrita atje nga ora nëntë. Burgu ishte në lagjen e sipërme të qytetit, i rrethuar nga të katër anët me mure të larta. Karshi tij ndodhej ndërtesa e madhe, ku kishte qenë «Konsullta italiane». Tani atje rrinin autoritetet e fashizmit.

Te porta e hekurt e burgut qëndronte roja, një burrë i trashë, me mustaqe të gjata, me një hundë të shtrëmbër e dhëmbë të mëdhenj, të cilët i dilnin shpesh mbi buzën e poshtme. Po atë fytyrë kisha parë atje edhe javën e kaluar. U drejtova tek ai me hapa të ngadaltë, duke e



shikuar në sy. Ai më hodhi një vështrim të ashpër dhe pastaj më thirri me zë të lartë:

Ku shkon, or lepur? Ndal atje!

Ndalova menjëherë. Ai bëri disa çape drejt meje.

— Cilin ke në burg?

— Babanë, Selam Sulën!

— Aha, ti ke qenë edhe javën e kaluar, ë?

— Isha, po!

— Qenke serbes i madh, more shejtan! Apo të ka marrë malli për ndonjë plumb kokës, hə? Prit atje tej, jezit! — tha tërë nerva. U largova nja dhjetë metra. Roja i thirri përgjegjësit, i cili doli menjëherë dhe filloi të bisedonte ngadalë me rojen. Diçka i thoshin njëri-tjetrit, duke parë herë pas here nga unë. Pastaj përgjegjësi, një skërfyell i gjatë e thatanik, m'u afrua, më shikoi për disa çaste vëngër dhe më pyeti:

— Selam Sulën ke baba ti?

— Po, Selam Sulën...

— Mirë! Prit!

Prita më se dhjetë minuta. Unë vështroja rojen, po edhe ai nuk i hiqte sytë prej meje. Pas ca, te dera e burgut u duk një oficer. Përgjegjësi i rojes, që e shoqëronte atë, e nderoi dhe u largua prej tij. Oficeri ishte një burrë nja 35 vjeç, me trup të shkurtër, trashalug, por i veshur mirë. Kapelen e mbante në dorë. Flokët i vetëtinin nga brilantina. Sa pa oficerin, roja mori drejtqëndrim. Oficeri nuk ia vari fare, por erdhi pranë meje.

— I Selamit je? — më pyeti.

— Po, i Selamit, — i thashë.

— Je i Selam Sulës, ë? Se kemi edhe Selamë të tjerë ne këtu!

— Po, — ia ktheva me drojtje.

Hyr brenda! — foli prerë. Unë ngela në vend. «Bobo,

— thashë me vete, — po më futin edhe mua në burg!» Por në të njëjtën kohë edhe u gëzova, se ashtu do të mund të takoja babanë, të cilin kisha dy muaj pa e parë e më kishte marrë malli shumë.

— Hajde pas meje, djalë, hajde! — tha oficeri, duke më buzëqeshur. — Mos ki frikë! — vazhdoi ai. Fillova të ecja pas oficerit. Si kaluam nëpër një korridor të gjatë të burgut, dolëm në oborr. Nisa të shikoja andej-këtej mos më zinte syri babanë, por këmbë njeriu s'dukej. Mbretëronte një heshtje e tmerrshme. Vetëm rojet, me helmetat e zeza në kokë, qëndronin seriozë dhe pa lëvizur pranë mitralozëve të rëndë, nëpër qoshet e oborrit. Një qen i vogël, me një rrip të kuq në qafë, kur na pa, lehu disa herë, pa luajtur fare nga vendi, pastaj pushoi. Kur u afruam, qeni u ngrit dhe i doli përpara oficerit. U fërkua pas çizmeve të tij të ilustruara, që vetëtinin si pasqyrë. Oficeri i fërkoi kokën dhe vazhdoi rrugën. Në këtë çast se kush shau me zë të lartë:

— Kriminelë! Të poshtër!

Ngadalësova hapat. M'u duk tamam si zëri i babait tim. M'u rrëqeth trupi. Oficeri kuptoi diçka, ktheu kokën nga unë. Eca prapë pas tij. As që po e kuptoja çfarë po ndodhte. Ai u kthye nga e majta. Para nesh u duk një ndërtesë e vogël njëkatëshe. Te dera e saj ishte një roje, i armatosur me një automatik të ri. Me t'u afruar oficeri, roja mori drejtqëndrim, kurse tjetri vështroi nga unë dhe tha,

— Ja, arritëm!

Hyri në zyrë. Unë ndenja te dera. Përballë meje ndodhej një dollap i madh me një pasqyrë. Për herë të parë në jetë pashë aty fytyrën time. Bobo, si m'u duk vetja, si mos më keq! Vetëm atëherë kuptova se pasqyra t'i nxjerri-kësh në shesh të gjitha, prej këmbëve deri te koka. Pantallonat i kisha copë-copë, këmbët të zbathura, këmishën

diku me andra e diku të grisur, flokët të pakrehur. Ula kokën, se më vinte turp të shikoja veten. Oficeri, si u ul vetë para tavolinës, diçka lexoi mbi një letër që nxori nga sirtari. Pastaj më ftoi të ulesha në një karrige, që ndodhej në fund të zyrës, te dera. U ula me drojtje të madhe. Prisia se ç'do të ndodhte me mua. Oficeri më shikoi me vërejtje dhe më tha:

— Demek, ti mor djalë, ke ardhur për babanë...

— Po, zoti oficer.

— A e do shumë atë?

— Si nuk e dua, e kam baba.

— Shumë mirë! Ashtu duhet, posi! Ta duash, se të ka bërë kokën, — tha ai. — Ç'i ke sjellë në atë shportë? — pyeti më në fund.

— Fiq — i thashë.

— Je lodhur kot, — foli me zë të zvargur.

— Pse?! — e pyeta i habitur. Menjëherë mendova se mos ma kishin vrrarë babanë. M'u rrëqeth trupi, djersë të ftohta ma mbuluan ballin. Fillova të dridhesha.

— Babanë tënd sot do ta lirojmë, — vazhdoi ai. U ngrita në këmbë.

— Do ta lironi? Vërtet?!

— Qysh tani, bile! Ja, do të lajmëroj rojen ta sjellë këtu, të marrë letrën e lirit dhe të niseni për në shtëpi!

Unë sa nuk fluturova nga gëzimi. Megjithatë nuk më besohej. Mos vallë po tallej ai fashist me mua? Oficeri nxori nga sirtari disa shkresa. Diç lexoi në një të njëjten prej tyre dhe u kthye nga unë:

— Ne, more djalë i mirë, nuk kemi interes t'i mbajmë të tjerët kot në burg, jo! Aq më tepër njerëz si babai yt, i cili na i tregoi të gjitha.

— Çfarë ju paska treguar!? — e pyeta.

— Po ja de, që ka qenë komunist, që ka qenë i gënjer,

që i ka ndihmuar ata kuqalashët, që janë bërë mbledhje në shtëpinë tuaj! Ja këto, ç'do të thoshte tjetër!

Unë mbeta i habitur. Nuk dija ç'të thosha. Vërtet t'i kishte tradhtuar shokët babai im? Jo, këtë nuk mund ta besoja! «Po sikur të jetë e vërtetë, — thashë me vete, — si do të dal para shokëve të mi në fshat? Ata do të më quajnë bir tradhtari, siç i thonë djalit të Sali agait, që u vesh marshall i milicisë!» Mendimet m'i ndërpreu oficeri.

— Tyt eti, more djalë i mirë, — foli ai prapë, — nuk i kujtohet vetëm se sa herë janë bërë mbledhje në shtëpinë tuaj dhe kush ka marrë pjesë në to. Pra, kjo pikë na ka mbetur akoma pa u plotësuar, por shyqyr, ja, erdhe ti të na i thuash, që babai të mos pengohet të dalë qysh tani. Shkresa e lirimit është gati. Ajo është e firmosur edhe nga vetë zoti prefekt i qytetit. Pra, hajt, fol, që të niseni sa më shpejt për në shtëpi, se ju zë nata rrugës.

— Çfarë të flas!? — pyeta krejt i habitur.

— Ja pra, dy fjalë: sa mbledhje janë bërë në shtëpinë tuaj dhe kush vinte në ato mbledhje!

— Po unë nuk di gjë, — i thashë oficerit. — Asnjëri nuk kam parë të vijë tek ne. — Në të vërtetë i dija të gjitha. Vetë disa herë kisha bërë roje se mos vinin milicët të kapnin babanë dhe shokët e tij.

— Aha, nuk ditke! Çuditë. Po ne vetë babai yt na ka thënë. Bile ai na ka përmendur edhe disa emra, por ka harruar të tjerët. Ja, për shembull, ai na ka thënë se në ato mbledhje vinin... Nuk të kujtohet kush?

— Jo.

— Dhe pastaj thua se e dashke babanë! — tha ai. — Hiç nuk e dashke, hiç. Vetëm për disa emra, që do të thoshe ti, ai sot do të ishte në shtëpi, të mblidhte veten, se është katandisur keq.

Ula kokën. E kuptova mirë dhëlpërinë e oficerit. Ai ndezi një cigare dhe dikë mori në telefon. Fliste në një

gjuhë të huaj, që unë nuk e kuptoja. Papritur zuri në gojë emrin dhe mbiemrin e babait tim. Pastaj lëshoi dorezën e telefonit dhe m'u drejtua mua:

— Ndihej babanë, more djalë! Mos e lër të kalbet në burg! A e di ti se ai tani, — vazhdoi oficeri, — nuk mban mend mirë, sepse pa dijeninë time disa policë kokë-gdhe e kanë rrahur shumë. Prandaj ti duhet ta ndihmosh atë që të dalë nga burgu. Fjala jote e shpëton atë. S'ka më keq se burgu, djalëëëë?

Unë heshta. Tani e mora vesh mirë se ai donte të nxirrte prej meje ato që s'kishte mundur t'i nxirrte nga babai për dy muaj me radhë.

— Demek, nuk do të tregosh, he?

— Ju thashë se nuk di asgjë nga ato që kërkoni.

Oficeri mori pamje të egërsuar:

— Ore majmun, po nuk tregove, ta dish se edhe ti do të kalbesh në burg si yt atë!

Ai erdhi pranë meje dhe më qëllloi në fytyrë me atë dorën e tij të madhe. Sytë më lëshuan xixa, veshët më gjëmuan fort dhe m'u drodh i tërë trupi. Oficeri më qëllloi rishtas. Vura duart në faqe. Ndenja ashtu për disa minuta. Pas pak, në zyrë hynë dy policë. Njëri prej tyre tha:

— E sollëm, zoti toger!

— Futeni brenda! — urdhëroi oficeri. Policët dolën dhe prunë sakaq babanë tim, të cilin, ndonëse e kishin lidhur, e mbanin fort. E njoha më tepër nga opingat, nga rrobat e shajakta dhe nga mustaqet, se nga fytyra nuk dallohej fare. Kishte ndryshuar në mënyrë të çuditshme: ishte me plagë, enjtje, gjak.

— Baba! — thirra dhe u turra ta puthja, por një polic më shtyu tutje me qytën e pushkës.

— Bir i babait! Edhe ty të paskan sjellë këtu?! — tha im atë e pastaj iu kthye oficerit:

— Jeni kriminelë të ndyrë! Edhe këtë fëmijë e paskeni burgosur? Ptu! — pështyu ai i egërsuar.

— Akoma në tënden ti, o Selam Sula? — sokëlliu oficeri. U ngrit në këmbë dhe iu drejtua babait:

— Ke dy muaj, or qafir, që po na pëlçet shpirtin! Por ...dëgjo tani, ose do të tregosh, ose, ta dish, këtë këlyshin tënd do ta bëjmë copë - copë, ja mu këtu, përpara syve të tu!

— Bisha të egra! — iu përgjigj babai. — Merruni me burrat; lëreni atë, se është fëmijë!

Ndërkaq oficeri vazhdonte të dridhej në mënyrë çuditërisht të papërmbajtur. U hodh mbi mua, nxori gjuhën si ndonjë qen i tërbuar, më kapi për dy duarsh, më ngriti përpjetë dhe ma përplasi kokën pas murit me sa fuqi kishte. Unë nuk ndjeva se ç'u bë më tej. Vetëm si në ëndërr dëgjova zhurmë, klithje dhe krismë armësh. Kur erdha në vete, pashë se ndodhesha në spital. Pas një jave më liruan. Shkova në shtëpi me kokë të lidhur. Por babanë tim nuk e pashë më qysh prej asaj dite. E kishin vrarë në çastin kur kishte qëlluar me shqelma oficerin kriminel, që ma kishte plasur kokën te muri.

Po, nuk e pashë më babanë tim të dashur! Veçse e kam gjithnjë të gjallë përpara syve, ashtu siç qëndronte para oficerit fashist: krenar, të fortë dhe të papërkulur, megjithë torturat që kishte hequr.

## NATËN, AFËR KISHËS

Viti 1945. Vendi ishte çliruar plotësisht, por në malet akoma endeshin njerëz të liq, kriminelë. I tillë ishte edhe Prengë Kola, i njohur në të gjithë krahinën për krimet e tij. Forcat e Mbrojtjes Popullore e kërkonin këmba-këmbës. Ku ta dija unë atëherë se do të isha bërë vetë shkak për kapjen e Prengës! Dhe ndodhi pikërisht kështu:

Një mbrëmje, nëna kishte harruar derën e katoit hapur dhe derri, e vetmja gjë e gjallë që kishim, pati ikur pa lënë gjurmë. U dëshpëruam pa masë unë, ime ëmë dhe babai. Ne prisim që ta majmim edhe ca dhe pastaj ta thernim për ta pasur ushqim për dimër, se dimri në anët tona zgjat shumë, deri në fund të qershorit. U nisëm të tre të kërkonim derrin. Mua, si më të voglin, më lanë të shikoja te pylli afër kishës, babai do të kërkonte në pyllin rrëzë malit, kurse nëna nëpër përroin e fshatit. Ishte bërë natë. Gjithandej qe errësirë. Unë ecja ngadalë dhe i bëja sytë katër. Dhe ja, duke ecur ashtu, ndjeva papritur një pëshpëritje. Ç'të ishte, vallë? Qëndrova në vend. Pastaj zgjata kokën dhe, për çudi, pranë trungut të një lisi të madh më zuri syri priftin e fshatit dhe kriminelin Prengë Kola. Ata diçka thoshin kokë më kokë. Ashtu i zbathur siç isha, iu afrova atyre edhe më, tinës e tinës.

— Ti ke shumë frikë, — i thoshte Prenga priftit.

— S'bëhet shaka me këta, — ia kthente prifti Prengës.

— Tani po iki, — tha më në fund Prengë Kola. — Mos harro ç'biseduam: të dielën, kur ti do të mbash messhën para besimtarëve, ne do të vrasim Prelën dhe Markun, dy komunistët e rrezikshëm të fshatit. Kur të dëgjosh krismat e pushkëve, ti do të thuash: «Perëndia dënon mëkatarët e saj!»

— Zoti ju ndihmoftë, — foli prifti. Pastaj ata i shtrënguan dorën njëri-tjetrit dhe kriminelit u largua. Mua nuk m'u durua më. U zhduka ngadalë, që të mos bija në sy të priftit dhe të Prengë Kolës. Si u largova mjaft prej tyre, ndalova të mbushesha me frymë. Ç'duhej të bëja? Të veja në postën e kufirit, ajo ishte shumë larg. Në çast dëgjova babanë që thirri:

— Gjergj! Kthehu në shtëpi, se e gjeta derrin! Marie! E gjeta derrin!

Pas pak që të tre u gjendëm pranë e pranë. Isha shumë i shqetësuar. Babai e kuptoi dhe m'u drejtua:

— Sa frikë paske pasur, more Gjergj! Po ti qenke bërë i bardhë gëlqere, more bir! Të doli ndonjë egërsirë përpara, apo si?

— Të dielën do të vrasin Prelën dhe Markun, — thashë unë.

— Ç'flet! — ma ktheu im atë.

— Të dielën, të dielën, — përsërita, pa e mbledhur dot veten.

— Qyqja, djali! — tha nëna. — Qenka tmerruar! Po flet përçart biri i nënës!

— Po, po, do t'i vrasin, — thashë unë. Babai m'u afrua, më zuri prej krahu dhe më foli:

— Bir, ti sot je marrosur! Ç'flet kështu për Prelën dhe Markun!?

Unë u qetësova pak, pastaj u tregova atyre se si qëndronte puna.



— Mos nuk ke dëgjuar mirë, mor bir? — më tha babai. Kurse nëna ma priti:

— Prifti është njeri i perëndisë! Ai nuk merret me kriminelë! Mos të kanë bërë veshët dhe sytë nga frika!

Mua më hipi inati në kokë. Gati sa nuk qava. Më në fund mezi më besuan.

— Krimineli iku? — pyeti babai.

— Po, i shtrëngoi dorën priftit dhe iku.

— Atëherë s'duhet humbur kohë; qysh tani duhet shkuar te prifti, — tha babai. Mori armën, më kapi mua për dore dhe u nisëm së pari te Prela e pastaj te Marku. Ecnim me të shpejtë. Kishim ftohtë. Po binte borë. Pas pak arritëm te shtëpia e Prelës. Qeni lehu me të madhe. Prela doli me të dëgjuar të lehurat e qenit. I treguam si ishte puna. Prej andej, bashkë me Prelën i vajtëm Markut në shtëpi. I thamë edhe atij si qëndronte puna. Pastaj babai, Prela dhe Marku, të tre të armatosur, dhe unë tok me ta u nisëm për në kishë. Kishte kaluar më se një orë nga çasti kur kisha parë priftin bashkë me kriminelin, Prengë Kola. Trokitëm te dera e qelës. S'na u përgjigj njeri. Në qelë kishte dritë. Trokitëm përsëri. Pas pak dëgjuam zërin e priftit:

— Kush është në këtë orë të vonë?

— Jemi bashkëfshatarë të tu, — tha babai.

— Ti, Gjon, je? Po pse natën, ore i uruar.

Prifti hapi ngadalë derën e qelës.

— A ke njeri brenda, o dom Pjetri? — pyeti im atë.

— Jo, për atë zot! — u betua prifti. Ne hymë në dhomë. Dhoma e tij ishte mbushur plot me libra fetarë, kryqe dhe disa letra mbi tavolinë. Pranë një kryqi të artë ndodhej një shishe verë. Një kitarë ishte hedhur mbi dollap. Unë qëndroja pranë babait dhe e shikoja priftin me urrejtje. Ai kishte rënë në ujdë për vrasjen e Prelës dhe Markut, që ishin njerëzit më të mirë të fshatit.

— Epo ndonjë hall ndoshta ju ka prurë këtu! — tha prifti.

— Hall i madh, besa, — tha Prela.

Epo hallet për robin janë, — tha prifti. — Hallet i krijoi perëndia për të parë zemrat e njerëzve se deri ku i durojnë vuajtjet që jep zoti! Njeriu pa halle është si ajo gjinkalla, që këndon e këndon e pastaj pëlçet!

— Po ti a ke ndonjë hall, o dom Pjetri? — pyeti Marku.

— Posi nuk kam! — tha prifti. — Edhe unë rob i zotit jam! Mendoj se qysh...

— Të vrasësh njerëz, — e ndërpreu babai.

— Mos perëndi! — ia priti prifti. — Ne e kemi të ndaluar të vrasim edhe një mizë dhe jo më njerëz!

Ai bëri shpejt e shpejt shenjën e kryqit. — Çfarë thua ashtu, biri im?! Ta dish se bën mëkat duke folur gjëra që nuk i pranon perëndia!

— Kur të dëgjosh krismat e pushkëve, ti do të thuash... Si do të thuash, dom Pjetri? — pyeti babai. Prifti e shikoi me habi. Fytyra nisi t'i bëhej ngjyra-ngjyra, herë i zverdhej e herë i skuqej.

— «Perëndia dënon mëkatarët e saj», — tha në mënyrë të theksuar Marku. Prifti zgurdulloi sytë.

— Ç'janë këto tallje me njeriun e perëndisë?! — kundërshtoi prifti.

— Harroke shpejt, dom Pjetri! — tha Prela. — Është plani që bëtë para një ore me kriminelin Prengë Kola.

Priftit tani s'i mbeti gjak në trup. Filloi të dridhej e djersë të ftohta i buluan mbi ballë.

— E paskeni kapur djallin! — tha me gjysmë zëri. — Sa shpejt paska kallëzuar, geni!

Ne nuk e zgjatëm. E morëm priftin dhe e çuam në Degën e Punëve të Brendshme, që ishte nja dy orë larg. Atje prifti u hoq «shumë i arsyeshëm». Duke kuj-

tuar se krimineli Prengë Kola ishte kapur, i tregoi të gjitha: ku e kishte strofkën krimineli, sa vetë kishte me vete, bile edhe sa herë ai vetë kishte shkuar në atë strofkë e u kishte dhënë «zemër e bekim» kriminelëve. Në bazë të informatave të tij, qysh asaj nate u nis një togë me ushtarë; me ata qenë edhe babai, Prela dhe Marku. Shpejt strofka e kriminelëve u rrethua e u sulmua duke u asgjësuar plotësisht.

Të nesërmen në mesditë fshati festoi asgjësimin e kriminelëve. Nga ajo ditë unë ruaj kujtime edhe sot e kësaj dite. Kam edhe një fotografi të zmadhuar, ku janë shkruar këto fjalë: «Njësiti që asgjësoi bandën e kriminelit Prengë Kola». Në mes të asgjësuesve, jam edhe unë, djalë i vogël dhjetëvjeçar. Ç'kënaqësi ndiej sa herë e shikoj!

## VDEKJA «AKSIDENTALE» E KAPTER XHELALIT»

Kjo ka ndodhur aty nga viti 1943, pikërisht në muajin mars. Në ato ditë spiunët në qytetin tonë ishin shtuar edhe më shumë nëpër qoshet e rrugëve e kudo, që i mbanin veshët hapur e përgjonin si langoj. Atyre u kishte hyrë lepuri në bark, sepse pikërisht dy ditë më më parë njësiit gueril kishte shtrirë përtokë, mu në mes të qytetit, spiunin e rrezikshëm, marshallin e kuesturës, Filipo Damianin. Gjithashtu, po ato ditë, spiuni i italianëve, Azemi, ishte gjendur i mbytur në një qoshe rruge. Prandaj fashistët ishin të egërsuar edhe më tepër. Ndalonin njerëz në rrugë, u kërkonin letrat e njoftimit dhe ndonjërin, kur dyshonin, e merrnin zvarë në xhandarmëri. S'mbeti njeri pa u gëzuar në qytetin tonë për vrasjen e këtyre spiunëve. Mirëpo gëzimi ynë nuk zgjati shumë: fashistët kishin vrarë përgjegjësin e grupit tonë të pionierëve, shokun Sali. Sa na pikëlloi neve kjo gjë! Ne e donim shumë Saliun, se ishte vërtet për t'u dashur. Ai ishte bir samarxhiu, njeri gojëmbël, por i ashpër me armiqtë. Megjithëse lodhej tërë ditën, duke punuar në një shoqëri ndërtimi rrugësh, gjente kohë të punonte edhe me ne pionierët. Sa herë na kishte mbledhur e na shpjegonte të zezat që i kishte sjellë fashizmi Shqipërisë! Dhe ja tani, atë na e kishin vrarë në kohën kur bashkë me një grup shokësh kishin hedhur bomba mbi një kazermë ushtarake, jashtë qytetit.

Sa mora vesh për vrasjen e Saliut, shkova tek Aliu, që ishte i organizuar në një grup me mua. Edhe ai e kishte marrë vesh vrasjen e tij. Heshti ca me nofulla të shtrënguara e më kujtoi si na thoshte Saliu: «Ç'do bir dhe bijë e këtij vendi duhet të bëhet pjesëmarrës në luftën çlirimtare! Liria nuk fitohet pa gjak! Dikush nga ne edhe mund të vritet! Armiku s'na ka ardhur për të mirë!» Si fshimë lotët, Aliu më tha:

— Shkojmë!

— Ku? — e pyeta.

— Atje, te vendi i vrasjes...

— A do ta mbajmë dot veten para fashistëve?

— Do ta mbajmë patjetër.

U nisëm. Rrugës shikonim njerëz që shkonin kokulur. Në një kthesë takuam xha Jakupin, që i kishte të dyja vajzat partizane.

— Ku veni, or bij? — na pyeti ai.

— Atje, — i thamë ne. Ai kuptoi gjithçka. Uli këren dhe vazhdoi rrugën. Saliun e kishin marrë nga kazeremat ku ishte vlarë, dhe e kishin vënë në sheshin para xhamisë, që të frikësonin popullin. Kur mbëritëm te sheshi, mua m'u drodh i gjithë trupi. Policët, me pushkë nëpër duar, qëndronin rreth e rreth dhe nuk lejonin njeri të afrohej. Të vlarin e kishin kthyer me fytyrë nga qielli. Por populli nuk u mblodh atje, siç shpresonin fashistët. Vetëm nja dhjetë vetë ishin. Midis tyre ishte edhe Qazim agai, i cili thërriste si ndonjë tellall i paguar:

— S'u ka faj qeveria, jo! Një mijë herë u ka dalë nga borxhi: «Mosni, bre, mosni!» Po marrin vesh këta! Dhe ja se çfarë i gjen! Oj, dashkan të luftokan me një qeveri të tërë! Kurse kapter Xhelali, i nxitur nga fjalët e Qazim agait, thoshte me zë të lartë, duke u drejtuar nga ata pak njerëz:

— E shikoni? Ja, kështu do ta pësojnë të gjithë ata,

që do të luftojnë kundër qeverisë! Se me qeverinë tonë nuk e hanë dot shtete të mëdha dhe jo dava leckamane nësi si këta, që s'kanë këpucë në këmbë dhe këmishë në trup!

Unë nuk i duroja dot mburrjet e këtij fashisti; Aliu kërciste dhëmbët nga dhembja për shokun Sali, por edhe nga inati për kapter Xhelalin. Ne e njihnim mirë kapterin, këtë fashist të urryer. Na dukej sikur ai ishte vrasësi i Saliut. Ne nuk po na ikej nga ai vend. Na dukej sikur bënim roje para trupit të shokut tonë! Mirëpo kapter Xhelali filloi të thërriste edhe më shumë e me zë më të lartë:

— Ja, ja, kështu do ta pësojnë të gjithë! Plumbin meritonjë komunistët, plumbin!

Nuk duruam më dhe u larguam, pa e dhënë veten para fashistëve. Por mendjen e kishim atje!

Të nesërmen në mëngjes (unë atë natë nuk mbylla sy) erdhi Aliu. Edhe ai dukej që nuk kishte fjetur. I ishin fryrë sytë nga pagjumësia.

— Duhet të hakmerremi për vrasjen e Saliut, — më tha.

— Me siguri do të hakmerret Partia, — ia ktheva.

— Pse, ne nuk jemi të Partisë? — më pyeti.

— Po jemi të vegjël, — i thashë.

— Si thoshte shoku Sali, të kujtohet? Kjo luftë nuk njeh të vegjël e të mëdhenj; të gjithë duhet të ngrihen për çlirimin e vendit! Prandaj, dëgjo këtu! Kam bërë një plan për të vrarë kapter Xhelalin.

— Ta vrasim ne?! — pyeta i habitur.

— E, more, ne, po kush?!

— Ne?! — u habita përsëri.

— Mos u habit! — tha Aliu. — Ai fashist duhet zhdukur nga faqja e dheut. A e pe si mburrej para trupit të shokut tonë?

Pastaj më tregoi planin. U çudita se si i kishte vajtur në mendje. Kapter Xhelali kishte një motoçikletë fringo të re. Dhe e ngiste atë shpejt, si nëpër pazar, ashtu edhe në periferi të qytetit. Aliu e kishte vënë re se, kur fillonte të errej, kapteri i hipte motoçikletës dhe shkonte në shtëpinë e Sulo agait, afër spitalit, gati në të dalë të qytetit. Zakonisht rrinte atje nja dy a tri orë e pastaj kthehej në shtëpinë e vet. Thoshin se kapter Xhelali ishte fejuar me të bijën e Sulos. Para se të arrije te shtëpia e këtij, ishte një urë e vogël, më pas vinte një e përpjetë që zgjaste gati një kilometër.

Planin tonë ia treguam edhe Reizit, i cili zëvendësoi shokun Sali. Ai, si u mendua ca, tha:

— Bukur e keni menduar. Vetëm se duhet kujdes! Pastaj na udhëzoi si ta kryenim edhe më mirë aksionin.

Kështu, një ditë filluam ta zbatonim. Me ne erdhi edhe vetë shoku Reiz, por qëndronte larg nesh, për të mos rënë në sy. Zhurma e motoçikletës së kapter Xhelalit u dëgjua në të gjithë qytetin. Ai u nis si përherë për te shtëpia e së fejuarës. Ne filluam të vepronim. Të them të drejtën, u frikësova ca, por nuk e bëra veten para Aliut. Ç'është e vërteta, ai ishte nja dy vjet më i madh nga unë dhe me trup më të bëshëm, ndaj e kuptoi frikën time e më tha:

— Çdo gjë do të përfundojë mirë! Pastaj, mos harro! Pranë kemi edhe shokun Reiz!

Shkuam shpejt nëpër errësirë te ura. Aty do të prisnim kapter Xhelalin, derisa të kthehej nga e fejuara. Nja pesë minuta më tej, dikush ndërtonte një shtëpi të re. Shkuam te ajo, morëm nja dy trarë dhe ndenjëm afër urës. Prit e prit, por kapteri nuk po dilte nga e fejuara. Kaloi një orë, dy, prapë ai s'po dukej gjëkund.

— Na dështoi plani, — thashë unë. — Sot ai dashka të flerë tek e fejuara.

— Presim edhe ca, — ma ktheu Aliu. Në këto fjalë e sipër u dëgjua zhurma e motoçikletës. Ne me të shpejtë i shtrimë trarët për së gjati në xhade, duke i mbështetur pas dy gurëve kilometrikë. Pastaj u larguam nja njëqind metra larg. Kapter Xhelali e kishte lëshuar motoçikletën tatëpjetë me shpejtësinë më të madhe. Dritat i kishte të fikura, sepse ato ditë ishte ndaluar rreptësisht ndezja e dritave natën. Pra, qe errësirë nga çdo anë. Megjithatë, kapteri e ngiste motoçikletën me shpejtësi në të errët, se edhe rrugën e njëhte mirë. Ne po prisnim nga çasti në çast përfundimin e aksionit. Dhe ja, ai erdhi. Sa hasi rrota e parë e motoçikletës te trari i parë, trupi i kapter Xhelalit u hodh si sustë nja pesë metra prapa. Motoçikleta bëri disa rrotullime, pastaj u përmbys me zhurmë të madhe, sikur të ulërinte për vdekjen e të zot.

Pas dy ditësh, një gazetë fashiste botoi lajmin e vrasjes «aksidentale» të njërit prej mbrojtësve më të vendosur të rendit fashist dhe fotografinë e tij, rrethuar me shirita të zinj. Kështu e qëruam një fashist.



## MË I MADHI GËZIM

Atë ditë babai erdhi nga puna më shpejt se çdo herë tjetër. Hoqi opingat, që i ishin bërë tërë baltë, gunën e vari në një gozhdë të madhe në mur dhe u ul në qoshe. Trazoi zjarrin me një copë dru, hapi duart dhe i afroi pranë zjarrit.

— Dreqi ta marrë, ftohtë! — tha.

— Si ky dimër, more burrë, — tha nëna, — nuk është parë ndonjëherë.

— Ashtu na duket neve, moj grua, pa dimrat njësoj janë!

— Jo, jo, si dimri i sivjetshëm mos ardh të kurrë!

Babai trazoi përsëri zjarrin dhe hodhi sytë nga unë.

— Po ti, Ceno, ç'bën?

— Hiç, — thashë. — Ja, kam ftohtë!

— Epo, dimri kështu e ka!

Im atë më vërejti rishtas, pastaj uli kokën dhe pshe-rëti i pikëlluar. U çudita me këtë qëndrim të babait. Ai kurrë s'më kishte shikuar drejt në sy si atë ditë!

— Cenoja këto ditë do të shpëtojë nga vuajtjet e fshatit! Do të shkojë në qytet, — i tha babai nënës.

— Në qytet Cenoja! Ç'thua, mor burrë?

— E, oj, e, në qytet, — përsëriti im atë.

— Po pse?

— Do të punojë te Selam agai. Atje do të hajë, do të vishet.

— Jo, jo, nuk e dërgoj djalin tek ai, — tha nëna.

— Po këtu me se do ta veshësh, — ia prishi babai. — Të paktën atje do ta mbushësh barkun me bukë! A nuk e shikon sa keq jemi katandisur?

— Kam frikë se mos ma mundon shumë djalin Selam agai, o burrë. Se agallarët s'ngopen me punën e të tjerëve!

Unë dëgjoja në heshtje. Nga një anë më vinte mirë që do të veja në qytet, por nga ana tjetër më vinte keq që do të ndahesha nga babai, nëna, motrat, vëllezërit! Por im atë e kishte vendosur. Që të nesërmen u nisëm për në qytet. Sytë m'u mbushën me lot. Edhe nëna qante, por mundohej të mos dukej para meje. Vëllezërit dhe motrat e mia (unë kisha tri motra dhe dy vëllezër) më përcollën gati një orë larg shtëpisë. Pastaj më puthën të gjithë me radhë dhe ia shkrepën të qarit. Po edhe unë qava. Më dukej sikur po ndahesha përgjithnjë nga njerëzit e mi. Gjatë rrugës, babai më merrte me të mirë:

— Te Selam agai do të jesh si në shtëpinë tënde, dëgjon? Atje bukë do të hash sa të duash, gjellë plot! Selam agai s'ka edhe fëmijë dhe do të të mbajë tamam si djalin e tij.

Por unë gjithnjë qaja. Edhe babai fshinte lotët, por fshehurazi meje. Kur arritëm në kodrën afër qytetit, babai më tha:

— Ja, shiko sa i bukur është qyteti! Ja edhe shtëpia e Selam agait, ajo atje në anë të qytetit! E shikon si duket?

Unë as që e kisha mendjen të shikoja shtëpinë e agait. Mendoja se si do të rrija vetëm pa nënën, pa babanë, pa vëllezërit, pa motrat, te një njeri që as e njihja dhe as e kisha parë.

Me të mbërritur në qytet, e çuam gomarin në han dhe u nisëm për te Selam agai. E gjetëm të shtrirë te një shezlong në oborr. Oborri ishte i madh dhe i mbushur

me pemë e lule. Agai qe burrë nja 50 vjeç, me mustaqe të gjata, me trup të hollë dhe me fytyrë të zeshkët. Në kokë mbante një feste të zezë prej kadifeje. Ashtu siç ishte shtrirë, dridhte një palë tespie të verdha me gishtat e tij të zverdhur nga duhani. Sa na pa që hymë, na shikoi një copë herë me vërejtje e pastaj na tha:

— E këtë më paske sjellë, more Hazbi?!

— Si urdhëron, — tha babai. — Ja, këtë, Hysenin!

— Shiko, shiko! Po ku punon dot ai, more lumëmadh!

Po ai është sa një mi, more Hazbi!

— Punon, punon, aga, — tha babai. — Ashtu duket, po është goxha djalë. Ka mbushur 16 vjetët.

— Vallahi, nuk ma mbushka syrin, po le të rrijë njëherë, le të rrijë!

Pastaj agai u kthye nga unë:

— E, a e di se ç'do të bësh këtu te ne, o i uruar?

— Jo! — iu përgjigja kokulur nga turpi.

— Ja, po ta them vetë. Në mëngjes, qysh pa gdhirë, do të marrësh qumështin te Safa. Pastaj do të fshish shkallët, oborrin dhe do të ujitësh lulet. Si të mbarosh këto, do të shkosh të mbledhësh ullinj. Hë, se harrova! Para se të vesh për ullinj, do të çosh në furrë bukën, byrekun, tavën ose ç'të kemi! Hë, i bën dot këto?

— I bën jahu, si nuk i bën! — tha babai, pa pritur përgjigjen time.

— Epo, të shohim, — foli agai. — Se e kisha unë këtu një pizeveng djalë, po filloi të bënte naze, derisa e ndoqa fare!

Që atë ditë fillova nga punët. Lodhesha sa s'ka. Por me bukë s'ngopesha. Ma nxirrnin nga hundët edhe atë të ngrënë, sidomos zonja, që shpesh më hakërrohej si e xhindosur:

— Haram, haram bukën që të japim! O dembel i dembelëve! Pastaj i drejtohej të shoqit: — Po ç'ma mban

këtë krimb, more matuf burrë! Po merr, ore, një tjetër për të qenë!

— Po se mos i japim para, moj grua! — i përgjigjej agai. — Pastaj ai vjen duke u rritur, nuk e shikon! — Dhe drejtohej nga unë e ma hiqte me shkop:

— Ore, ti miu i mureve, o do të punosh mirë, o do të të çoj në fshat që të vdesësh për bukën e gojës!

— Po duke punuar jam, — thosha unë dhe mbaja me zor kurrizin, që më digjte nga shkopi i agait.

Një ditë më erdhi shpirti në majë të hundës. Vendosa të kthehem në fshat, në shtëpi. Më mirë të vuaja për bukë, sesa të duroja shkopinjtë e agait dhe të sharat e të pështyturat e zonjës. Por, kur po merrja byrekun në furrë, takova atje fshatarin tim, Idrizin. E dija që ai punonte në kriporen e qytetit, por deri atëherë nuk e pata takuar ndonjëherë. Ai, sa më pa, më puthi dhe më pyeti se si i kisha punët. I shpjegova gati duke qarë si më mundonte agai me zonjën, si më rrihnin e më pështynin. Idrizi psherëtiu dhe më tha:

— Mos ki merak, se do të të shpëtojmë nga këta të poshtër! — Pastaj shtoi se do të vinte të më takonte, kur të veja për të mbledhur ullinj. Dhe me të vërtetë erdhi të nesërmen. Bashkë me të erdhën edhe disa të rinj të tjerë. Asnjërin prej tyre nuk e njihja. U takova me Idrizin dhe pastaj edhe me të tjerët. Idrizi më hodhi krahun dhe më ftoi të ecnim bashkë. Të gjithë (ishin nja tetë të rinj) u ulëm nën hijen e një ulliri të madh.

Ata më folën për luftën që bënin partizanët, më thanë se tani populli kishte Partinë e tij, se do të vinte shpejt dita kur në Shqipëri s'do të kishte as pushtues, as bejlerë e as agallarë, pa edhe im atë do të kishte tokën e vet, pa edhe fëmijët e fshatarëve do të mbanin këpucë e do të shkonin nëpër shkolla. Eu, sa shumë gjëra të bukura më

treguan, sa që ma ndezën zemrën e ma mbushën kraharorin me zjarr.

I pashë me radhë në ata sytë që u shkrepëtinin dhe u thashë gojëplot:

— Po unë, a mund të bëj gjë për ato që folët ju?

— Si jo! — m'u përgjigj ai më i rrituri, duke më rrahur krahët. — Tani për tani mjafton të urresh fashistët, tradhtarët, të gjithë ata që na thithin gjakun.

— Oh, sa për atë... — ia ktheva dhe s'dija ç'të shtoja më tepër.

Shokët buzëqeshën.

— Pa pastaj, — tha Idrizi, — të tjerat vijnë me radhë. Ke dëgjuar për aksionet ti? Po? Shumë mirë. Tani more vesh se edhe kush i kryen. Bukur. Nesër mundet që edhe vetë të ngarkohesh me ndonjë detyrë, se Partia ka besim tek ti. Ti je njeri i shtresës; troç, fshatar i varfër. Kështu? Bukur, apo jo?

Ai çast më mbeti i paharruar për tërë jetën. Dhe fjala «bukur» që prej asaj dite mori për mua një tingëllim fort të ëmbël.

Pas asaj dite unë pata vërtet gëzime për sukseset në aksione. Unë mësova përse duhej jetuar e luftuar.

## RRËFIMI I MËSUESES

Kisha disa muaj që vazhdoja të jepja mësim në një shkollë të një komuneje, në Italinë e Jugut. Emri i komunes nuk ka rëndësi për lexuesin, sepse të tilla komune në këtë vend ka shumë; ato i ngjajnë njëra-tjetrës si dy pika uji. Shkolla ku jepja mësim ishte si një lloj kazerme e gjatë, me dërrasa, të cilat kishin filluar të kalbeshin. Shpeshherë unë i zhvilloja mësimet nën «këngën» e vazhdueshme të krimbave, që ishin futur në dërrasat dhe trarët e klasës. Bile dhe bankat ishin aq të vjetra, sa që plaku më i moçëm i komunes, xha Felicja, thoshte se ato qenë bërë qysh në kohën e Garibaldit.

Në fillim, në klasën time ishin 35 nxënës, por pas disa muajve vinin rregullisht vetëm 25. Po ku ishin dhjetë të tjerët? U interesova për ata nxënës te prindërit e tyre e ata më thanë: «Ne duam që fëmijët tanë të mësojnë, po ku na lënë taksat! Nuk jemi në gjendje t'i paguajmë ato. Nuk i durojmë dot taksidarët, kur na vijnë me karabinierët prapa për të na kërkuar taksat e shkollës».

Unë, të dashur lexues, nuk do t'ju tregoj sot për ato taksa, por për nxënësen time të zgjuar Anën.

Po, Ana ishte nxënëse e klasës sime. Ajo nuk i kishte mbushur ende 14 vjetët, megjithatë dukej si grua e rritur. E gjatë, e hollë, me sy të zes e me fytyrën të zbetë dhe të dobët, të linte përshtypjen sikur sa kishte dalë nga spitali. Nuk e di pse më hyri kaq shumë në zemër ajo vajzë! E doja si një shoqen time, megjithëse e kisha nxënëse

dhe isha shumë më e madhe në moshë. Më dhimbej, kur e shikoja me atë fustanin basmë, që nuk e mbronte aspak nga të ftohtët. Me fustanë basme visheshin pothuaj të gjitha vajzat e klasës sime, por ato sikur ishin më të shëndosha se Ana, ndaj mua më dukej sikur kishin më pak të ftohtë! Ndoshta kjo vinte ngaqë unë kisha një simpati të veçantë për Anën! Ndoshta!

— Ana, — i thashë një ditë, — nuk ke ndonjë triko ta veshësh? — Ajo më shikoi në sy, pastaj uli kokën dhe më tha me zë të ulët:

— Jo, ne jemi të varfër, mësuese! Triko këtu, te ne, veshin vetëm gratë!

Edhe unë ula kokën dhe u pendova që i bëra atë pyetje.

Ç'është e vërteta, unë shkoja në shkollë heret në mëngjes. Më bënte përshtypje se shumë vajza, ndër to edhe Ana, vinin në minutat e fundit. Unë u kisha tërhequr vëmendjen atyre për vonesën; ato vetëm ulnin kokën dhe skuqeshin në fytyrë. Nuk thoshin asnjë fjalë. Njëherë u fola rreptë, por edhe atë radhë ato heshtën. T'ju them të drejtën, më vinte të pëlçisja nga ajo heshtje e tyre e çuditshme, por s'kisha ç'të bëja!

Një ditë, në dërrasën e zezë ngrita Anën. Bënte të ftohtë i madh. Ana dridhej. Megjithëse më vinte keq, nuk desha t'i bëja lëshim në mësim. I konsideroja të gjithë njësoj, pavarësisht nga simpatitë që kisha për njërin ose për tjetrin. I thashë të shkruante një fjali dhe pastaj ta analizonte atë nga ana gramatikore. Ajo mori shkumësin dhe nuk u mendua aspak siç e kanë zakon të bëjnë nxënësit, por shkroi menjëherë, me dorën që i dridhej: «Sot padronia më rrahu dhe më la pa bukë». Unë e shikoja Anën me vërejtje. Edhe ajo më shikoi mua drejt në sy, sikur donte të më bindte se çka kishte shkruar në dërrasë, ishte e vërtetë. Shikuam njëra-tjetrën për disa çaste.

Por ja, në atë kohë u hap dera dhe në klasë hyri një grua e re, e veshur mirë, me një tualet të rëndë, me këpucë lustrafine dhe me një çantë elegante në dorë. Fustanin e kishte aq të shkurtër, saqë krejt gjunjët i mbeteshin jashtë. Ajo hodhi sytë nga nxënësit, pa shikuar fare nga unë dhe nga Ana. Mua nuk m'u durua dhe e pyeta menjëherë.

— Kë kërkoni, zonjë?

Ajo ktheu kokën, pa Anën dhe tha:

— Ja, këtë shejtankën dua!

— Tani jemi në mësim, — i thashë. Në të vërtetë, unë as që e dija se cila ishte ajo zonjë aq e papërfillshme dhe e paedukatë, sa nuk kërkoi lejë, por hyri në mënyrë arrogante. Gruaja më hodhi një shikim të rreptë dhe me një kryelartësi të çuditshme, ma ktheu:

— Ana më shërben mua, zonja mësuese! Unë do të shkoj te im vëlla, se ashtu e kam punën, dhe ajo do të më mbajë djalin.

Pastaj iu kthye Anës:

— Shpejt Ana! S'kam kohë të rri këtu me kalamajtë!

Ana nuk po luante nga vendi. Ajo hodhi sytë drejt meje, sikur të kërkonte ndihmën time.

— Luaj, moj bushtë! — iu kërcënua zonja Anës.

— Zonjë, mbani gojën! — i thashë. — Nuk ju ka hije të flisni fjalë të tilla!

— Mos doni t'i them zonjushë?! — pyeti ajo me ironi. — Ha, ha, ha, ha! Epo, helbete, mësuese moderne, de! — u tall ajo me mua. Pastaj hodhi sytë nga dërrasa e zezë dhe lexoi se çfarë kishte shkruar Ana. U vrenjt në fytyrë, kafshoi buzët, pastaj iu afrua vajzës ngadalë:

— E, moj shtrigë e keqe, ç'ke shkruar ashtu në dërrasën e zezë, hë?

— Të vërtetën kam shkruar, — guxoi t'i përgjigjej Ana. — Ti më rrahe dhe më le pa bukë!



— Ptu! Ndyrësirë e keqe!

Mua nuk m'u durua. Iu afrova asaj dhe i thashë:

— Ju lutem, dilni përjashta! Mos më ndërprisni mësimin! Kjo që po bëni ju, është në kundërshtim me ligjet dhe me edukatën!

— Nuk kam punë me ty! — tha zonja. — Ti di vetëm të mësosh kalamajtë, po jo mua!

Dhe iu turr Anës, e kapi prej krahu dhe po e tërhiqte zvarë. Ana e gJORë ia krisi të qarit. Unë e kapa zonjën e çmendur nga krahu dhe ia prita:

— Lëshojeni Anën, zonjë! Ajo tani është në mësim!

— Atë e di unë, — tha gruaja, duke u dridhur nga inati. — Unë e ushqej me bukë, unë mund t'i bëj ç'të dua!

Pastaj i kërciti Anës dhëmbët:

— Luaj, moj ndyrësirë e keqe! Luaj, të them, se do të ta marr shpirtin!

Ana me një rën dorë mbahej fort pas bankës së parë, që zonja të mos e tërhiqte dot. Atëherë zonja e qëlloi fort me pëllëmbë në faqe. Vajza filloi të qante me ngashërim, jo aq nga dhembja sesa nga turpi, që po i shkaktonte ajo grua e pacipë. E shtyta zonjën me forcë. Ajo ra mbi një bankë të nxënësve. Pastaj u ngritën nxënësit dhe desh iu hodhën në grykë. Ajo e kuptoi rrezikun dhe iku me vrap, duke sharë e duke lëshuar jargë, tamam si ndonjë bush-tër e tërbuar. Si u vendos qetësia në klasë, Ana tregoi se punonte tek ajo pasanike e komunes prej më se dy vjetësh. Disa vajza të tjera u ngritën dhe më thanë se edhe ato punonin te pasanikë të asaj komuneje dhe trajtoheshin si kafshë. Punonin vetëm për bukën e gojës. Dhe ishin të gjitha nga ato që vinin me vonesë në shkollë. Pra, bënë shumë punë para se të niseshin.

Por puna nuk mbaroi me kaq. Pas një ore, në klasë

hynë dy karabinierë. Ata në fillim u drejtuan nga nxënësit dhe thirrën gati në një gojë:

— Fëmijë! Të gjithë jashtë!

Nxënësit mbetën të habitur. Ata hodhën sytë nga unë dhe më panë me vërejtje. U ktheva nga karabinierët dhe thashë:

— Fëmijët janë në mësim! Tani sa filluan orën e tretë!

Ata më vështruan me inat. Pastaj njëri prej tyre, ai që mbante gradën e tetarit, më tha:

— Ju do të vini me ne, zonjushe!

— Zonjushe qytetare! — u tall tjetri.

— Përse të vij me ju?! — pyeta.

— Sepse keni bërë krim, zonjushe qytetare, — tha tetari.

— Unë krim? Jo, zotni, unë s'kam bërë ndonjë krim!

— Si guxoni të thoni se nuk keni bërë krim!? — foli tetari. Po, a nuk jeni ju që keni guxuar të rrihni zonjën e nderuar Marçela Adriano, të shoqen e të nderuarit Marko Adriano, kryesekretarit të komunes sonë, hë?

— Jo, zotërinj, nuk e kam rrahur! Ajo na prishi mësimin, na fyeu.

— Hajde, hajde! — thirri tetari. — Ne zbatojmë urdhrin! Përpara! Përpara!

Unë ktheva kokën nga nxënësit dhe i shikoja me dashuri. U buzëqesha. Ata u ngritën menjëherë më këmbë, sikur donin të më nderonin, dhe më ndoqën me vërejtje kur dola nga klasa. Në fytyrat e tyre dukej pikëllimi për mua, mësuesen, që pa bërë asnjë faj, po më merrnin karabinierët.

Në hetuesi më morën disa herë me radhë në pyetje. Zonja e pacipë, e cila më kishte akuzuar për rrahje, nga inati kishte pickuar mishrat në disa pjesë të trupit për të paraqitur prova rrahjeje. Kështu, u dënova nga gjykata

me gjashtë muaj burg dhe me heqjen e së drejtës së profesionit dy vjet rresht.

Qysh prej asaj dite nuk e kam parë më as Anën dhe as shoqet e saj. Pasi mbarova burgun, u ktheva në qytetin tim të lindjes, që është shumë larg nga komuna ku jepja mësim. Por e marr me mend se si do të jenë ato: më të zgjatura, më të zbeta në fytyrë, më të dobëta, duke punuar nga mëngjesi e deri në darkë nëpër arat dhe shtëpitë e pasanikëve të komunes! Ky është fati i mijëra e mijëra vajzave të sotme të Italisë. Kurse unë vazhdoj të jem pa punë.

## TREGIMI I XHA KOLIT PËR XHIM KOKERIN!

Xha Koli ka disa vjet që është kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai kishte shkuar në atë vend qysh më 1930, kur te ne nuk kishte punë. Tani xha Koli banon në një pallat me mua. Edhe ju mund ta keni parë xha Kolin! Është një plak që mezi ecën, duke u mbajtur fort mbi një shkop të trashë. Ai tregon mjaft historira nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ja një nga ato!

\*

\* \* \*

Banoja në një lagje zezakësh të një qyteti të madh amerikan. Në fillim kisha qenë pjatolarës dhe më vonë kamerier te një restorant i një zezaku. Atje vinin për të ngrënë vetëm zezakë, se, në Amerikë, të bardhët kanë hotele, pijetore, klube, plazhe, ku lexohen parulla të mëdha, të ndriçuara me llamba elektriku: «Vetëm për të bardhët», «Ndalohej hyrja e zezakëve». Në fillim unë u çudita se si bëhej ky dallim midis njerëzve, por, kur u miqësova me zezakët, ata më shpjeguan se ç'ndodhte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një ditë, në restorantin ku punoja erdhi një grua plakë, bashkë me një burrë. U ulën në tavolinë. Plaka e puthte burrin herë pas here dhe nga sytë e saj lotët dilnin çurkë. U afrova dhe e pyeta plakën:

— Përse qani, zonjë?

— Djali, — tha ajo, duke më treguar burrin pranë, djali! — Pastaj, si fshiu lotët, vazhdoi:

— Njëzet vjet në burg! Ja, tani sa doli, biri i nënës!

— Rreth tavolinës u mblodhën edhe shumë zezakë të tjerë. Dikush e përqafonte burrin, disa habiteshin:

— Pa shikoni, Xhimi! Xhim Kokeri!

Po, ai quhej Xhim Kokeri! E kishin futur njëzet vjet përpara në burg, që kur ishte 14 vjeç. Po përse, vallë? Më ka mbetur në mendje tregimi i Xhimit! Prandaj dua ta tregoj tamam ashtu siç ma tregoi Xhimi dhe nëna e tij, Xhoana:

«Po luaja në një shesh të vogël, nja treqind metra larg shtëpisë sime. E ndieja veten shumë të kënaqur atë ditë, sepse mamaja më kishte ushqyer mirë; më kishte dhënë edhe pjesën e saj të proshutës, se gjoja i dhimbte koka dhe nuk i hahej. Kisha një top llastiku dhe isha duke lozur me të. Pas pak, pranë meje u afruan dy djem të bardhë, të veshur e të mbathur. Diçka folën vesh më vesh, pastaj njëri prej tyre më thirri tërë inat:

— Ej, ti, zezak! Hajde këtu!

Unë bëra sikur nuk e dëgjova dhe vazhdova të lozja. Ata diçka i thanë prapë njëri-tjetrit dhe me hapa të shpejtë ecën drejt meje:

— More zezak i ndyrë! Pse nuk na përgjigjesh, kur të thërresim? — Ktheva kokën nga ata. I pashë me vërejtje. Në të vërtetë ato fytyra i kisha parë edhe herë tjetër, por asnjëherë nuk më kishte rënë rasti të bisedoja. E dija se njëri prej tyre ishte i biri i togerit Xhon Frejder, kurse tjetri, kushëriri i tij. Kujtova se mos do të pyesnin për ndonjë adresë, ose kushedi për çfarë tjetër!

— Këtu jetojnë vetëm zezakë, — u thashë. — Kërkoni njeri?

— E dimë, ore ndyrësirë, se këtu jetojnë vetëm ze-

zakë, — ma ktheu njëri nga ata dhe më pështyu në fytyrë. U tërhoqa pak mënjane, fshiva fytyrën dhe u fola me inat:

— Ç'keni me mua? Përse më ngitni?

— Që kur ke mësuar ti, zezak i ndyrë, të mos na përfillësh ne të bardhët? — m'u kërcënua njëri, duke më treguar grushtat. U afruan të dy pranë meje, me duart prapa.

— Më lini të loz! — u thashë unë. — Ç'ju bëra që më ngisni?

I rashë topit me këmbë e bëra të largohesha. Por më kapën fort nga mëngët e më thanë duke kërcitur dhëmbët:

— Ti nuk do të shkosh, or krimb i zi, jo! Ti tani je në dorën tonë.

— Lëshomëni! — bërtita. I biri i togerit Xhon Frejder më shtrëngoi fort nga krahu. I kushëriri i tij më zuri krahun tjetër.

— Ti, — tha ai, — si dënim që nuk na përfill ne të bardhët, do të hipësh në atë mur dhe do të hidhesh që andej.

I hodha sytë murit. Ai ishte më se katër metra i lartë. Pastaj poshtë kishte gurë. Po të hidheshe prej andej, gjeje vdekjen, ose vriteshe rëndë.

— Jo, — iu përgjigja, — nuk mund të hidhem! Lëshomëni!

— Të bëjmë ne që të hidhesh, — më thanë ata. Dhe ashtu si më kishin kapur, më tërhoqën zvarë deri pranë murit, e më urdhëruan të hipja lart. Kundërshtova dhe desha të shkëputesha prej tyre. Atëherë filluan të dy të më qëllonin me shqelma, me grushta. Mundohesha t'u shpëtoja goditjeve të tyre. Ata zgërdhieshin dhe kënaqeshin duke parë se si rënkoja. Por nga një shqelm në koskën e gjurit të djathtë ndjeva aq dhembje, saqë e humbë durimin; iu hodha me forcë atij që më goditi dhe

ia përplasa kokën pas murit. Nuk e di se ku e gjeta gjithë atë fuqi! Ai ra përmbys në tokë, lëshoi një «oh» dhe nuk u dëgjua më. I kishte rënë të fikët. Ishte pikërisht djali i togerit Xhon Frejder. Kur e pa i kushëriri atë skenë, ia krisi vrapit, duke thirrur me lemeri:

— Ej, na vrau zezaku! Obobo! Na vrau zezaku! — Dhe, për çudi, sikur gjithçka të ishte përgatitur, erdhi me të shpejtë një xhips me disa policë brenda. Ata më morën menjëherë me shqelma dhe më hodhën në xhips. Desha t'u shpjegoja se si kishte ndodhur aksidenti, por nuk më lanë të flisja. Kështu më futën brenda. Pas disa ditëve më dënuan me 20 vjet burg, se kisha rrezikuar jetën e një të bardhi!..»

Xha Koli mori frymë thellë, nxori çibukun e mbushi me duhan dhe psherëtiu thellë:

— Ja, kështu ndodh në Amerikë me zezakët, kështu! Dhe ja ç'tregoi e ëma e Xhimit, plaka e mirë Xhoana, — vazhdoi xha Koli.

— Unë e prita djalin, por ai nuk erdhi. S'mbylla sy gjithë natën! Pastaj shkova në farë e fisin tonë për të pyetur mos Xhimi kishte shkuar te ndonjëri nga ata. Të gjithë më thoshin: «Jo, nuk e kemi parë». Më në fund shkova në polici. Hyra drejt e te shefi:

— Më ka humbur djali, — i thashë.

— Ç'moshë ka? — më pyeti.

— Sa ka hyrë në të katërmbëdhjetat.

— Si e quajnë?

— Xhim! Xhim Kokeri...

Shefi u ngrit në këmbë, vuri duart mbi tavolinë dhe thirri si ndonjë egërsirë:

— Pse, moj shtrigë, ti qenke nëna e kriminelit Xhim?

Desha të flisja, por ai më ndërpreu:

— Ti, moj zezake e ndyrë, paske pjellë një kriminel kaq të rrezikshëm?

Bëra një hap prapa, u tremba nga ai qëndrim i egër i shefit dhe nuk po kuptoja asgjë.

— Ç'thoni kështu, zoti shef? — thashë. — Unë jam nëna e vogëlushit Xhim! Ju me siguri më ngatëroni.

— Jo, moj zezake e ndyrë, — tha shefi. Pikërisht djali yt, Xhimi, është një kriminel i dorës së parë! Ai ka goditur gati për vdekje djalin 15-vjeçar Arnold Frejder, të birin e togerit të nderuar Xhon Frejder.

Mbeta e habitur. Djersë të ftohta më mbuluan ballin.

— Zoti shef, — fola ngadalë, — më besoni! Xhimi është i urtë, i sjellshëm! Nuk është kriminel! Me siguri e keni fjalën për ndonjë tjetër.

Shefi mori inat, u ngrit nga kolltuku, më kapi nga krahu dhe më hoqi zvarë.

— Ku më çon, ku më çon? — bërtita. Por ai vazhonte të më tërhiqte zvarë me forcë, duke gulçuar e duke kërcitur dhëmbët. As e mora vesh se si u ndodha para një ndërtese të mëdha me dyer të hekurta.

— Ja, kriminelin tënd, shikoje! — m'u kërcënua. Hodha sytë andej, kur, ç'të shihja, Xhimin, shpirtin e nënës, të gjakosur si mos më keq!

— Xhim! Bir! Ç'ka ndodhur kështu me ty, or bir? — thirra unë. Xhimi, ndërmjet të qarave, m'u përgjigj:

— **Nënë! Nuk kam faj, nënë! Nuk kam faj!**

Ai deshi të thoshte edhe diçka tjetër, por policët, si egërsira, e tërhoqën me forcë dhe e futën në qeli».

— Po, — e përfundoi xha Koli tregimin e tij. — Xhimi nuk kishte asnjë faj. Ai ishte mbrojtur nga ata që e sulmuan pa asnjë shkak, por në Amerikë, që të mbrohesh kur të sulmojnë të bardhët, për zezakët është krim.

Dhe xha Koli pështyu me gjithë shpirt:

— Ptu! Padronë të ndyrë! Ptu! Amerikë e ligjeve të poshtra!



## DJALI I XHA ANTONIOS

Xha Antonioja hyri me të shpejtë në dhomë. Hodhi sytë nga krevati prej druri, ku ishte shtrirë dhe lëngonte prej disa ditësh djali i tij i vetëm, Xhovani. Mbi krye të djalit pa të shoqen, që po i shkonin lotët çurkë.

— E, si duket Marie? Është ndonjë çikë më mirë?

Gruaja ngriti kokën, i hodhi një sy të shoqit dhe mërmeriti ngadalë:

— Keq, Antonio! Më keq nga ç'e le ti në mëngjes!

— Ashtu?!

Ai iu afrua krevatit, u ul në gjunjë dhe i hoqi djalit një shami, që ia kishte vënë e ëma në fytyrë për të mos e bezdisur mizat. Fëmija qëndronte pa lëvizur, me sy të mbyllur. Ngjyra e fytyrës së tij dukej e verdhë, e verdhë si dylli.

— Xhovani! Xhovani! Jam babai, shikomë, bir, jam babai! Hapi sytë, bir, jam babai, më dëgjon?

Djali luajti pak, hapi sytë me zor, hodhi vështrimin nga i ati, pastaj nga e ëma e më në fund u kthye në anën tjetër ngadalë, duke nxjerrë një «oh» të dhimbshëm. E ëma filloi të qante me ngashërim. I ati i vuri dorën mbi ballë.

— Bir i babait, digjesh si furrë! — pëshpëriti ai. —

— Djali duhet shtruar patjetër në spital, — tha gruaja.

— Edhe doktori që e vizitoi, kështu tha.

— Thotë doktori, thotë, por nuk thotë se ku do t'i gjejmë paratë, — foli xha Antonioja. — Ne mezi pa-

guam për vizitën që i bëri djalit, jo pastaj të pagauajmë spitalin. Ku t'i gjejmë të hollat, he, thuaj ti, ku t'i gjejmë?

— Merr një certifikatë vobektësie nga kryeplaku, — tha e shoqja. — Ne jemi të varfër!

— E kam menduar, — iu përgjigj xha Antonioja, por nuk dua t'i bie ndër këmbë atij qeni kryeplak! Ti e di që unë jam zënë me të! Pastaj kam folur kundër zgjedhjes së tij. Ja, kjo më ka penguar që nuk kam vajtur deri tani!

Për disa çaste ai ra në mendime. Hodhi sytë nga fëmija, pastaj u ngrit menjëherë dhe, duke ecur gati me vrap, u gjend pranë shtëpisë së kryeplakut, sinjor Xhudiçes. Kur arriti te dera e tij, qëndroi për disa çaste, fshiu djersët dhe filloi të mendohej. Që nga larg një erë e freskët valëviste degët e pemëve, me të cilat e kishte mbushur oborrin kryeplaku. Fërkoji mjekrën, të parruar kushedi prej sa ditësh, me duart tërë kallo. Pastaj me hapa të ngadaltë hyri në oborr. Menjëherë sytë i zunë kryeplakun, një burrë thatanik, me sy të zes dhe me një mjekër të bardhë, që ishte shtrirë në një shezlong dhe po lexonte gazetën «Il popolo». Edhe tani xha Antonioja desh të kthehej, por iu kujtua djali, djali i tij i vetëm, që e kishte lënë gati duke vdekur. Dhe, pa ditur as vetë se si, tha me gjysmë zëri.

— Mirëmëngjes zoti Xhudiçe!

Kryeplaku ngriti kokën, pa me vërejtje xha Antonion dhe tundi kokën në shenjë përgjigje. Xha Antonioja e kuptoi mospërfilljen e kryeplakut, por nuk e bëri veten. Kryeplaku lëshoi gazetën, u ngrit këmbëkryq dhe iu drejtua xha Antonis me një vështrim të egër dhe me ton gati kërcënues:

— E, erdhe të më kërkosh ndjesë për akuzat që më bëre? E dija! E kisha të qartë, o Antonio kokëforti!

— S'kam ardhur të të kërkoj ndjesë, jo, por për djalin, se e kam sëmure...

— Aha, paske djalin sëmure?! Epo, ç'kërkon prej meje? Ti e di, ore i uruar, që unë nuk jam as doktor dhe as shënjtor, që të shëroj djalin tënd! Ë? Apo nuk e di!

— Dua një çertifikatë vobektësie, — tha xha Antonioja. — Dua ta shtroj djalin në spital!

— Aha, dashke një çertifikatë vobektësie, që të shtrosh djalin në spital...

— Po, — iu përgjigj Antonioja. — Djalin e kam në gjendje shumë të rëndë!

— Po çfarë ka djali, more Antonio?

— Digjet si furrë...

— Oh, kollaj fare! Hidhi ujë të ftohtë! — tha kryeplaku me qesëndi. — Freskohet kësisoj, freskohet, e di unë! Hi, hi, hi! — u zgërdhi ai.

Xha Antonioja mori një pamje të vrenjtur, vetullat e tij të trasha iu ngritën përpjetë.

— Sinjor Xhudiçe! — tha ai me ton të rreptë. — Ju po talleni me mua! Unë kam hall, kam djalin sëmure, dëgjoni ç'ju them?

Ai iu afrua edhe më shumë kryeplakut. Trupi filloi t'i dridhej:

— Kush ju dha juve të drejtë të talleni me fatkeqësinë e tjetrit, sinjor Xhudiçe, kush?

Edhe kryeplaku mori pamje serioze. Mjekra nisi t'i dridhej. U kthye në çast nga xha Antonioja:

— Mos harro, Antonio kokëforti, se ti më ke fyer në mbledhjen e fshatit! Dhe tani po vjen të më kërcënohesh?

— Nuk të kam fyer, kam thënë...

— S'më paske fyer? Po a nuk je ti që the për mua se jam njeri pa vlerë, se pi tërë ditën, se nuk meritokam të jem kryeplak e shumë gjepura si këto?

— Por kjo nuk ka të bëjë aspak me lëshimin e çertifikatës së vobektësisë, — tha xha Antonioja. — Ti e ke për detyrë ta bësh këtë! Ti e di që unë jam i varfër!

— E di që je i varfër nga ekonomia, por je i pasur nga gjuha! — ia ktheu Xhudiçja!

— Sinjor! Mos u bëj shkakhtar që të më vdesë djali i vetëm! Ti duhet të mendohesh mirë për këtë që po bën!

Kryeplaku mori pamje të egër dhe i tha xha Antonios:

— Sikur ta di se edhe ai djali yt do të bëhet kështu si ti, komunist — merre vesh mirë, o Antonio gjuhëgjati — do ta lija të vdiste si miu!

Dhe ashtu, tërë inat, nxori nga xhepi një letër dhe stilografin dhe diçka shkroi në të. Pastaj ia zgjati xha Antonios:

— Na, merre dhe shko në komune ta firmosësh! Duhet të ta firmosë vetë kryetari i komunes, ndryshe nuk ka vlerë!

— Obobo! — tha xha Antonioja. — Po komuna mban dy orë që këtej!

— Epo si thua zotrote, ta sjellim kryetarin e komunes këtu për qejfin tënd?!

Xha Antonioja e shikoi me inat kryeplakun dhe, pa i dhënë përgjigje, iku me të shpejtë.

Pas dy orësh, tërë djersë e lodhje, ngaqë të shumtën e rrugës e kishte bërë me vrap, arriti në zyrat e komunes. Kërkoj menjëherë kryetarin, por i thanë se ishte në kafene bashkë me sekretarin e komunes. Me vrap hyri në kafene. Kryetarin nuk e njihte, se nuk e kishte parë asnjëherë, pasi ai ishte emëruar kohët e fundit. Pyeti të zotin e kafenesë dhe ai i tha se kryetari ishte ai që po lozte kumar. Xha Antonioja u nis drejt tij. I drojtur, i lodhur e i dërmuar, iu drejtua me zë të ngadaltë:

— Sinjor kryetar!

— Pesë! — thirri kryetari, duke hedhur me forcë let-rën e kumarit në tavolinë.

— Ti pesë, unë shtatë! — thirri tjetri përballë tij.

— Sinjor kryetar! — përsëriti xha Antonioja, por këtë radhë me zë të lartë dhe të vendosur.

— More, ç'është ky hajvan, që po më bie më qafë! — mërmëriti ngadalë kryetari i komunes, një burrë i trashë, me një fytyrë rrumbullake, me gjyzlykë me rrathë floriri dhe me një mjekër të bardhë, të vogël.

— Ju lutem, një firmë dhe një vulë! — tha xha Antonioja.

— Ç'është kjo, more?! — pyeti kryetari i komunes me sytë dhe mendjen te letrat e kumarit, që ishin hedhur në tokë.

— Një certifikatë vobektësie, sinjor kryetar, — foli prapë Antonioja.

— O Krisht, o shën Mëri, sa të pagdhendur që mbetën këta fshatarët tanë! — tha kryetari. — Po pse, ore, zyrë e bërë ti kafenenë, që më sjell këtu shkresën?

— Po ju këtu jeni, — u përgjigj Antonioja, — këtu erdha dhe unë!

— Lëri llafet dhe shko e prit në zyrë, se do të kthehem pas pak! Ik!

— E kam punën me ngut, e kam djalin shumë të sëmurë!

— E more vesh, de, e mora. Shko në zyrë, se do të kthehem, të thashë! Po ik, ore, se më prishe lojën! Po qenke fare i pagdhendur, ore i paudhë!

Xha Antonioja shtrëngoi grushtat dhe doli ngadalë nga kafeneja. Vajti e zuri vend te zyrat e komunes. U mbështet pas murit. Ngaqë ishte lodhur, e zuri një gjumë i lehtë. Pa në ëndërr sikur djali kishte hipur mbi një kalë të bardhë dhe ecte revan. E ëma e ndiqte nga prapa,

se kishte frikë mos e rrëzonte kali. Por ëndrrën ia ndërpreu shërbyesi i komunes, i cili iu afrua dhe i tha:

— Ej, mik, cilin prisni këtu?

Xha Antonioja u hodh përpjetë dhe pa se prapa tij ndodhej një burrë thatanik, me një çibuk në gojë.

— Kryetarin pres, kryetarin, — iu përgjigj xha Antonioja. — A mund të vijë shpejt kryetari?

— Po fitoi në kumar, vonohet, — tha shërbyesi, — se vete ia shtron me të pirë, po të mos fitojë, vjen shpejt!

— Ptu! — pështyu xha Antonioja. — Kjo është e tmerrshme!

— Si e ke punën, ç'kërkon? — pyeti shërbyesi. Xha Antonioja i tregoi hallin. Shërbyesi psherëtiu:

— Eh, të mjerët ne! Prite, prite, se do të vijë. — Xha Antonioja u ngrit, ndezi një cigare, mendoi: «Eh, ku kemi arritur! Na shajnë, na përzënë, s'na mbarojnë punë! U shofshin që të gjithë e një mos mbettë!»

Pas më se dy orësh arriti në zyrë kryetari i komunes. Xha Antonioja, sa e pa, i doli përpara, i hoqi kasketën në shenjë nderimi. Kryetari i komunes as që i vuri veshin xha Antonjos. Ai dukej tepër i mërzhitur, shenjë që tregonte se kishte humbur në kumar. Duke u mbajtur mbi bastunin, ecte ngadalë.

— Sinjor kryetar! — tha xha Antonioja. Kryetari i hodhi një vështrim të rreptë dhe e pyeti:

— Ç'kërkon?

— Jam unë...

— Aha, ti që erdhe në kafene?

— Po, sinjor, unë!

— Epo si e ke hallin?

— Kam djalin shumë sëmurë. Dua ta shtroj në spital, por jam i varfër! Kam marrë një certifikatë vobektësie nga fshati. Mbetet që ta firmosni ju.

Kryetari ndaloi në vend. I hodhi një shikim xha Antonios prej këmbëve deri te koka dhe tha:

— Qenke munduar kot, more i shkretë!

— Pse?! — thirri xha Antonioja, të cilit iu rrëqeth gjithë trupi.

— Sepse dje na lajmëruan se instituti bamirës «San Xhiovani», ku ne kemi të drejtë të shtrojmë të sëmurë të varfër të komunes sonë, është mbyllur me afat të pacaktuar!

— Bobo! — u drodh xha Antonioja. — Po tani nga t'ia mbaj? Ku të mbytem?

Filloi të ecte prapa kryetarit. Kryetari ndaloi dhe iu kthye:

— Dëgjo, more njeri! Instituti është mbyllur, se është grindur Ministria e Shëndetësisë italiane me administratën e provincës. Ministria thotë që shpenzimet e këtij instituti t'i paguajë provinca, provinca thotë t'i paguajë ministria! Ja, kështu! — vazhdoi kryetari, duke hyrë me të shpejtë në zyrë.

Xha Antonioja qëndroi për disa çaste në këmbë dhe pastaj nisi të ecte, pa ditur se ku po shkonte.

## PËRMBAJTJA :

Kur dola partizan .....	3
Dështimi i një dredhie .....	7
Natën, afër kishës .....	15
Vdekja «aksidentale» e kapter Xhelalit .....	20
Më i madhi gëzim .....	25
Rrëfimi i mësueses .....	30
Tregimi i xha Kolit për Xhim Kokerin .....	36
Djali i xha Antonios .....	41